

VEND I LIRË PUNE KOORDINATOR I HAPËSIRAVE NË QENDRËN PËR PRAKTIKË RRËFYESE

Qendra për Praktikë Rrëfyese u ndërtua si një institucion nga Manifesta 14 Prishtina, ngjarje që u mbajt në Kosovë gjatë verës e deri në vjeshtën e vitit 2022. Misioni i Manifesta 14 ka qenë gjithmonë ndërtimi i një institucioni të qëndrueshëm për dhe me qytetarët e Prishtinës. Qendra do t'i shërbejë komunitetit artistik, studentëve dhe punëtorëve të kulturës si një hapësirë për risi artistike, bashkëprodhim, mësim dhe ndërtim të rrjetit profesional prej pranverës së vitit 2023 deri në vjeshtën e vitit 2026 në Prishtinë, Kosovë dhe do të udhëhiqet nga Bordi i Manifesta 14 Prishtina. Anëtarët e përzgjedhur të ekipit do të punojnë për gjashtë muaj, me mundësinë e kohëzgjatjes së punës për 3.5 vite der në përfundim të vitit 2026.

Qendra për Praktikë Rrëfyese (CNP) synon të ndërtojë aftësi duke ofruar burimet dhe mjetet për të mësuar, hulumtuar, ndarë dhe transferuar aftësitë në fushat e industrive krijuese. Qendra për Praktikë Rrëfyese me vetëdije dhe në mënyrë pro aktive sfidon paramendimin se mendimi dhe praktikat artistike janë fushë veprimi për të privilegjuarit, qëllimi po ashtu është të zgjerojë qëllimin dhe të krijojë qasje të gjërë për të gjitha audiencat. CNP synon të forcojë artet, kulturën dhe sektorin publik duke ofruar hapësirat aq të nevojshme apo mjediset, mjetet, pajisjet dhe aftësitë për të gjithë.

Qendra për Praktikë Narrative është në kërkim të një Koordinatori të Motivuar dhe me përvojë të Hapësirave nga Kosova për të qenë pjesë e ekipit të CNP-së. Koordinator i Hapësirës është përgjegjës për menaxhimin e funksionimit të përditshëm të vendit, duke siguruar që hapësirat, pajisjet, arti/punimet dhe hapësirat e jashtme të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe që prezantimi i përgjithshëm të përmbushë standardet e larta.

KOHËZGJATJA DHE STATUSI

Dita e fillimit	1 janar 2023
Pozitë me kohë të plotë	Duke përfshirë mbrëmje dhe fundjava të caktuara
Vendndodhja e punës	Prishtinë, Kosovë
Koha e provës	6 muaj
Orët	40 orë në javë.

Përgjegjësitë Primare

Përgjegjësia kryesore e Koordinatorit të Hapësirës është mbarëvajtja e përditshme e vendit dhe do të koordinojë stafin ndihmës dhe hapjen dhe mbylljen e hapësirës, do të ofrojë asistencë teknike për aktivitetet dhe ngjarjet e programuara dhe do të sigurojë furnizime për programin dhe hapësirat.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Menaxhimi i përditshëm i vijueshmërisë së punëve në hapësirë, të sigurojë hapësirat, pajisjet, punimet artistike punë të tjera dhe të sigurohet se hapësirat e jashtme të funksionojnë mirë e që prezantimi i tyre të jetë gjithmonë i standardeve të larta
- Koordinimi i hapjes dhe i mbylljes së hapësirës dhe stafin mbështetës.
- Të menaxhojë mirëmbajtjen e përditshme të hapësirës në mënyrë të duhur.
- Të veprojë si person kontakti për materialet që dërgohen në vend.
- Të veprojë si person kontakti për të kontraktuarit që punojnë në këtë hapësirë.
- Të vërë në punë pajisjet dhe hapësirën për aktivitete të brendshme dhe të jashtme.
- Të monitorojë disponueshmërinë e materiale dhe mjeteve dhe të jetë përgjegjës për porositjen dhe dërgimin e materialeve në kohë të përshtatshme.

- Të jetë përgjegjës për furnizimin, menaxhimin dhe monitorimin e barit.
- Të ofrojë mbështetje teknike për programues të jashtëm e bashkëpunëtorë
- Të monitorojë e të mirëmbajë pajisjet e Qendrës për Praktikë Rrëfyese dhe te menaxhojë riparimet e tyre në raste të nevojshme.

AFTËSITË DHE EKSPERIENCA E KËRKUAR

- Të paturit së paku 2 vite eksperiencë pune në një pozicion të ngjajshëm,
- Të njohë rrjetin e furnizuesve vendorë dhe të profesionistëve të sprovuar.
- Njohuri në zgjidhje të problemeve teknike, në ndërtim, prodhim, shtypje dhe në materiale audio-vizuale.
- Aftësi për të punuar mirë nën presion duke patur parasysh afatet.
- Aftësi për të ndërvepruar me bashkëpunëtorë ndërkombëtarë.
- Të ketë rrjedhshmëri në shkrim dhe të folurit në gjuhën shqipe dhe angleze. Njohja e gjuhëve të tjera është e pëlqyeshme.
- Njohuri në Microsoft dhe Dropbox
- Vullnet për të punuar jashtë skemës dhe të ketë mundësi për të udhëtuar.
- Të paturit vullnet, mprehtësi dhe vëmendje ndaj detajeve.

SHPËRBLIMI

Pagesa përcaktohet në varësi të eksperiencës.

Si të aplikohet për këtë pozicion pune?

Ju lutemi të na dërgoni aplikimin tuaj për punë dhe CV, në gjuhën angleze duke iu referencuar në subjekt: Venue Coordinator Centre for Narrative Practice nënë m14jobs@manifesta.org deri më 15 dhjetor 2022.

Kandidatët e suksesshmëm do të ftohen në intervistë.